



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 10 regjistër (JR)
Datë 19.02.2019

Nr. 8 i vendimit
Datë 25.06.2020

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Luan Daci	Kryesues
Albana Shtylla	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 25.06.2020, ora 09:30, në ambientet e Pallatit të Kongreseve, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 10/2019 (JR), datë 19.02.2019, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Darjel Sina.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 86, datë 17.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet C, pika 2, F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisionerin Publik, i cili përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 86, datë 17.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, e cila kërkoi përfundimisht lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, ushtron detyrën e gjyqtares dhe kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), Komisioni, bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe c) Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “KLD”), sipas të cilave ka rezultuar sa më poshtë.
2. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - o *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
 - o *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
 - o *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
 - o *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
 - o *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
3. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.
4. KLD-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nëpërmjet rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm për subjektin e rivlerësimit.
5. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga organet ndihmëse si më sipër, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, duke marrë vendimin nr. 86, datë 17.12.2018.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

6. Komisioni, me vendimin nr. 86, datë 17.12.2018, vendosi: “Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, me funksion gjyqtare dhe kryetare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë [...]”.
7. Ky vendim është marrë bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “a” dhe 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme, për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit.

7.1 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

Nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit, rezulton se subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka pasur burime financiare të ligjshme e të mjaftueshme.

Pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur rezulton të jetë e ligjshme, nuk ka deklaram të rremë apo të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë.

Subjekti nuk gjendet në situatë konflikti interesi.

7.2 Për kontrollin e figurës:

Subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

7.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale:

Subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

8. Komisioneri Publik Darjel Sina (në vijim “Komisioneri Publik”), më datë 31.01.2019, ka ushtruar ankim¹ ndaj vendimit të Komisionit nr. 86, datë 17.12.2018, për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke kërkuar kryerjen e një hetimi të plotë të këtij kriteri. Sipas Komisionerit Publik, procesi i hetimit i Komisionit për kriterin e vlerësimit të pasurisë nuk është i plotë, ka mangësi dhe, për rrjedhojë, në gjendjen që janë faktet dhe provat nuk mund të konkludohet se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

Komisioneri Publik ka kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”) që, në përfundim të gjykimit të çështjes, të vendosë ndryshimin ose lënien në fuqi të vendimit nr. 86, datë 17.12.2018 të Komisionit.

9. Në ankim, Komisioneri Publik ka kundërshtuar konkluzionet e Komisionit për pasurinë apartament me sipërfaqe 141,87 m², në rrugën “{***}”, ndërtesa {***}, hyrja {***}, apartamenti {***}, Tiranë (në vijim “apartamenti me sipërfaqe 141,87 m²”), pasuri në pronësi të babait të subjektit të rivlerësimit.
10. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

10.1 Komisioni ka bërë vlerësim të gabuar të situatës faktike bazuar në aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, pasi rrethanat ligjore që paraqiten për pasurinë apartament me sipërfaqe 141,87 m² në Tiranë, janë të tilla që e lidhin subjektin e rivlerësimit në marrëdhënie interesi që rrjedh nga një interes pasuror me babain e saj, z. S.H., e për këtë arsye babai i saj duhet të cilësohej si person tjetër i lidhur.

10.2 Me cilësimin si person tjetër të lidhur të babait të subjektit të rivlerësimit, Komisioni do të duhej të verifikonte edhe përmbushjen e detyrimit ligjor të justifikimit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 141,87 m². Komisioni nuk ka hetuar mbi mundësinë financiare të prindërve të subjektit të rivlerësimit për kryerjen e investimit prej 11.065.860 lekësh, për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 141,87 m², pasi nga të dhënat e dosjes së hetimit administrativ, nuk rezulton që ata të kenë pasur mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie me të ardhura të ligjshme.

¹ Protokolluar në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 31.01.2019.

IV. Kundërshtimet e subjektit të rivlerësimit

11. Subjekti i rivlerësimit, më datë 08.02.2019, i është drejtuar Kolegjit me kundërankim² ndaj ankimit të Komisionerit Publik. Apeli kundërshtues i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit lidhet vetëm me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe vetëm për ato çështje të vlerësimit të këtij kriteri, të cilat janë ankimuar nga Komisioneri Publik.
12. Në kundërankim, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar kundërshtimet ndaj shkaqeve të ankimit, të cilat, në mënyrë të përmbledhur, janë si më poshtë.

12.1 Gjatë hetimit administrativ të Komisionit, ka rezultuar se nuk ekziston asnjë interes pasuror ose marrëdhënie tjetër biznesi ndërmjet subjektit dhe babait të saj, për ta konsideruar atë si person tjetër i lidhur në kuptim të ligjit nr. 84/2016, pasi institucionet financiare kanë konfirmuar se ndërmjet subjektit dhe prindërve e vëllait të saj nuk është kryer asnjë transaksion financiar, ndërsa zyrat e noterisë kanë konfirmuar se në asnjë rast ndërmjet subjektit dhe të afërmeve të saj nuk është kryer asnjë veprim juridik në formën e një kontrate dhurimi, huadhënieje apo huamarrjeje. Interpretimi i zgjeruar i dispozitave të ligjit nr. 84/2016 nga Komisioneri Publik është tërësisht i gabuar dhe në tejkalim të kompetencave të tij.

12.2 Pretendimi i Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit, nën regjimin e ekonomisë familjare të prezumuar, ka kontribuar në krijimin e kësaj pasurie, për aq kohë sa ka qenë në përbërje të njëjtë familjare me babain e saj deri në datë 30.01.2011, nuk qëndron. Subjekti, në deklaratimet e pasurisë në vitet 2007-2012 nuk ka deklaruar kursime, duke provuar kështu se ajo nuk ka pasur asnjë mundësi objektive për të kontribuar në krijimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 141,87 m².

12.3 Pretendimi i Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e përdorimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 141,87 m² nuk qëndron, pasi një fëmijë nuk ka ligjërisht dhe moralisht asnjë pengesë ose limit në kohë se sa herë shkon në familjen e prindërve të tij, për më tepër që kjo marrëdhënie njerëzore të trajtohet si marrëdhënie interesi.

13. Në përfundim, në kundërankim, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Kolegjit mosmarrjen parasysh të pretendimeve të parashtruara në ankimin e Komisionerit Publik, si të pambështetura në prova e në ligj, si dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 86, datë 17.12.2018, të Komisionit.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegj

a) Juridiksioni i Kolegjit

14. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.

Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

² Protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 08.02.2019.

b) Legjitimimi i ankuesit

15. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

16. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 86, datë 17.12.2018, për subjektin e rivlerësimit, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në prani të palëve.

B. Aspektet procedurale lidhur me hetimin e kryer nga Kolegji dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor

17. Komisioneri Publik në parashtrimet e tij në seancën gjyqësore të datës 19.02.2020, pasi u shpreh se u qëndron shkaqeve të ankimit, mbështetur në parashikimin e nenit F, pikat 3 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkoi që shkaqet e parashtruara në ankimin e paraqitur prej tij të merreshin në konsideratë nga trupi gjykues i Kolegjit, duke e cilësuar si person tjetër të lidhur, z. S.H., babain e subjektit të rivlerësimit, si dhe kërkoi hetimin në drejtim të burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 141,87 m².

Bazuar në këtë kërkesë, si dhe në shkaqet e ankimit, trupi gjykues i kërkoi Komisionerit Publik të paraqiste pretendimet konkrete në lidhje me nevojën e hetimit gjyqësor dhe drejtimet në të cilat duhet të shtrihej ky hetim.

Komisioneri Publik, në ndryshim nga sa ishte shprehur në ankim dhe në parashtrimet në seancë gjyqësore publike, e kushtëzoi nevojën e hetimit për mjaftueshmërinë e burimeve të babait të subjektit të rivlerësimit, z. S.H., për krijimin në vitin 2012 të pasurisë apartament me sipërfaqe 141,87 m², me kërkesën për shprehjen nga ana e trupit gjykues nëse babai i subjektit të rivlerësimit është person tjetër i lidhur me të. Trupi gjykues çmoi që në lidhje me këtë kërkesë të Komisionerit Publik të shprehej në vendimin përfundimtar.

Në mungesë të shprehjes së trupit gjykues të Kolegjit në lidhje me cilësimin ose jo të z. S.H., babait të subjektit të rivlerësimit, si person tjetër i lidhur me të dhe në përgjigje të kërkesës së përsëritur të trupit gjykues në lidhje me nevojat konkrete të hetimit referuar shkaqeve të ankimit, Komisioneri Publik u shpreh se nuk ishte e nevojshme të kryheshin veprime hetimore të mëtejshme, pasi aktet e ndodhura në dosjen gjyqësore ishin të mjaftueshme për të konkluduar që babai i subjektit të rivlerësimit kishte mungesë të burimeve financiare për krijimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 141,87 m², ashtu siç edhe ishte parashtruar në shkaqet e ankimit. Por, sipas Komisionerit Publik, analiza financiare e paraqitur në shkaqet e ankimit, ishte kryer në kushtet kur babai i subjektit të rivlerësimit nuk ishte prezumuar si person tjetër i lidhur me të, prandaj nga Kolegji do të duhej të kryhej hetim nëse subjekti i rivlerësimit dhe vëllai i saj kishin kontribuar me të ardhurat e tyre në krijimin e kësaj pasurie. Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me këtë kërkesë të Komisionerit Publik, u shpreh se nga ana e Komisionit është çmuar, pas një vlerësimi të thelluar administrativ dhe pasi është interpretuar ligji në tërësinë e vet, se ajo dhe babai i saj nuk mund të cilësohen persona të tjerë të lidhur. Në këto kushte, nuk është hetuar më tej nga Komisioni për sa i përket aftësisë paguese të babait të saj, për pasurinë apartament me sipërfaqe 141,87 m².

18. Trupi gjykues i Kolegjit, pavarësisht mungesës së konsekuencës së Komisionerit Publik në lidhje me arsyet e kërkesës për hetim të shprehur në ankim, në raport me qëndrimin e tij të shprehur në seancë gjyqësore publike, me vendim të ndërmjetëm të datës 19.02.2020, për nevoja të hetimit të çështjes, me qëllim kryerjen e analizës financiare për verifikimin e ligjshmërisë së burimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 141,87 m², të kërkuar nga Komisioneri Publik, vendosi të çelë hetimin për të verifikuar marrëdhënien që ka pasur babai i subjektit të rivlerësimit, z. S.H., me këtë pasuri.
19. Bazuar në pikën 3 të nenit F të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenet 45 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit i kërkoi informacion dhe akte shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” ShA, shoqërisë “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” ShA, shoqërisë “{***}” ShPK, shoqërisë “{***}” ShPK dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë. Gjithashtu, u ftua subjekti i rivlerësimit që, nëse e vlerësonte të nevojshme, të paraqiste dokumente, shpjegime dhe prova në kuadër të hetimit të çelur.
20. Trupi gjykues i Kolegjit:
- 20.1 Me shkresën nr. {***} prot., datë 21.02.2020, i kërkoi shoqërisë “{***}” ShPK informacion në lidhje me kontrata të tjera të mëparshme të lidhura mes kësaj shoqërie dhe z. S.H., me numër personal {***} dhe numër karte identiteti {***}, apo me persona të tjerë, për pasurinë e përshkruar në “Kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme me rezervë”, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.07.2012, me objekt premtimi i shitjes së një apartamenti, tip A, apartamenti nr. {***}, godina nr. {***}, në katin e tretë të banimit, me sipërfaqe totale ndërtimi 141,87 m², në Tiranë.
- Në përgjigje të kërkesës së Kolegjit, shoqëria “{***}” ShPK, me shkresën pa nr. prot., dhe me datë mars 2020, e protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 04.03.2020, informon se lidhur me apartamentin në fjalë nuk ka kontrata të tjera të mëparshme të lidhura me shtetasin S.H. apo dhe me persona të tjerë, përveç kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.07.2012.
- 20.2 Me shkresën nr. {***} prot., datë 21.02.2020, i kërkoi shoqërisë “{***}” ShPK informacion në lidhje me kontrata të tjera të mëparshme të lidhura mes kësaj shoqërie dhe z. S.H., me numër personal {***} dhe numër karte identiteti {***}, apo me persona të tjerë, për pasurinë e përshkruar në “Kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme me rezervë”, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.07.2012, me objekt premtimi i shitjes së një apartamenti, tip {***}, apartamenti nr. {***}, godina nr. {***}, në katin e tretë të banimit, me sipërfaqe totale ndërtimi 141,87 m², në Tiranë.
- Në përgjigje të kërkesës së Kolegjit, shoqëria “{***}” ShPK, me shkresën pa nr. prot., me datë 02.03.2020, e protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 03.03.2020, informon se kjo shoqëri ka qenë vetëm në rolin e shoqërisë së ndërtimit, sipas lejes së miratuar nga Bashkia Tiranë. Në këto kushte, nuk posedon dokumentacion për kontratat apo aktet e shitjes së objektit, të kryera nga pala shitëse “{***}” ShPK.
- 20.3 Me shkresën nr. {***} prot., datë 21.02.2020, i kërkoi shoqërisë “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” ShA informacion në lidhje me:
1. kontratën e furnizimit me energji elektrike me nr. {***} dhe datë hapjeje 11.05.2011, për pasurinë apartament banimi, rruga “{***}”, ndërtesa {***}, hyrja {***}, apartamenti {***}, Njësia Administrative Nr. {***}, Tiranë;

2. historikun e kontratave të furnizimit me energji elektrike për apartamentin e sipërcituar, pagesat e kryera para dhe pas datës 11.05.2011, për secilën kontratë, si dhe kopje të njësuara me origjinalin për secilën prej këtyre kontratave apo akteve.

3. aktet me të cilat janë regjistruar kontraktuesit për apartamentin e sipërcituar, si dhe akte që tregojnë kryerjen e pagesave sipas kontraktuesve.

Në përgjigje të kërkesës së Kolegjit, shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal ShA - OShEE GROUP ShA (në vijim "FShU ShA-OShEE GROUP ShA"), me shkresën nr. {***} prot., datë 17.04.2020, e protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 21.04.2020, informon se me gjeneralitetet Alma Kolgjoka, nuk rezulton të ketë abonent dhe as kontratë të furnizimit me energji elektrike me OShEE ShA.

Bashkëlidhur shkresës janë përcjellë kopje të listëpagesës, si dhe kopje të formularit me detaje të abonentit për kontratën me kod klienti {***}, në emër të z. S.H..

20.4 Me shkresën nr. {***} prot., datë 08.06.2020, trupi gjykues i Kolegjit i kërkoi shoqërisë FShU ShA - OShEE GROUP ShA të plotësonte informacionin e kërkuar për sa vijon:

1. Cili ka qenë historiku i kontratave të furnizimit me energji elektrike për apartamentin e sipërcituar, pagesat e kryera para datës 11.05.2011, për secilën kontratë, si dhe kopje të njësuara me origjinalin për secilën prej këtyre kontratave apo akteve.

2. Aktet me të cilat janë regjistruar kontraktuesit për apartamentin e sipërcituar, si dhe akte që tregojnë kryerjen e pagesave sipas kontraktuesve.

Në përgjigje të kërkesës së Kolegjit, shoqëria FShU ShA - OShEE GROUP ShA, ka përcjellë me *e-mail*, më datë 17.06.2020, informacionin e protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 17.06.2020, sipas të cilit me gjeneralitetet Alma Kolgjoka, nuk rezulton të ketë abonent dhe as kontratë të furnizimit me energji elektrike me OShEE ShA. Kontrata nr. {***}, në instancën Tiranë, është hapur më datë 11.05.2011 dhe, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, i përket abonentit S. A. H.. Bashkëlidhur shoqëria ka përcjellë dokumentacionin që disponon nga arkiva: kopje të formularit mbi kërkimin e informacionit të kërkuar nëse rezultojnë abonentë nga sistemi i faturimit të OShEE ShA, që përfaqëson bazën e të dhënave të shoqërisë, kopje të formularit me detaje të abonentit për kontratën e sipërpërmendur, si dhe kopje të faturimit të abonentit për periudhën 2011-2020.

20.5 Me shkresën nr. {***} prot., datë 21.02.2020, trupi gjykues i Kolegjit i kërkoi shoqërisë "Ujësjiellës Kanalizime Tiranë" ShA (në vijim "UKT ShA") informacion në lidhje me:

1. kontratën e furnizimit me ujë me nr. {***} dhe datë hapjeje 10.01.2011, për pasurinë apartament banimi, rruga "{***}", ndërtesa {***}, hyrja {***}, apartamenti {***}, Njësia Administrative Nr. {***}, Tiranë;

2. historikun e kontratave të furnizimit me ujë për apartamentin e sipërcituar, pagesat e kryera para dhe pas datës 10.01.2011, për secilën kontratë, si dhe kopje të njësuara me origjinalin për secilën prej këtyre kontratave apo akteve;

3. aktet me të cilat janë regjistruar kontraktuesit për apartamentin e sipërcituar, si dhe akte që tregojnë kryerjen e pagesave sipas kontraktuesve.

Në përgjigje të kërkesës së Kolegjit, shoqëria UKT ShA, me shkresën nr. {***} prot., datë 17.04.2020, e protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 21.04.2020, informon se nga kontrolli i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit, kontrata me nr. {***}, rezulton e regjistruar në emër të z. S. A. H. me status aktiv, në kategorinë e konsumatorëve familjarë me detyrime të likuiduara deri në muajin janar 2020. Kjo kontratë është aktivizuar në SMI në vitin 2010 dhe është bërë ndryshim emri në vitin 2012 nga {***} në emër të z. S.H.. Në

arkivin e UKT ShA nuk disponohet dokumentacion për hapje kontrate, si dhe dokumentacion për ndryshimin e emrit. Pagesat për kontratën, për periudhën janar-gusht 2011 janë kryer pranë Tirana Bank dhe nga periudha shtator-janar 2020 janë kryer rregullisht pranë arkave të UKT ShA, referuar informacionit të SMI. Bashkëlidhur shkresës, janë përcjellë të dhënat e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për pagesat e kryera në lidhje me këtë kontratë.

20.6 Me shkresën nr. {***} prot., datë 21.02.2020, trupi gjykues i Kolegjit i kërkoi Dhomës Kombëtare të Noterisë (në vijim “DhKN”) informacion në lidhje me:

1. kontrata të tjera të mëparshme të lidhura nga z. S.H. me numër personal {***} dhe numër karte identiteti {***}, përveç “Kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme me rezervë”, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.07.2012, për pasurinë e përshkruar në kontratën e sipërcituar;

2. kontrata të tjera të lidhura për pasurinë e përshkruar në “Kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme me rezervë”, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.07.2012, nga znj. Alma S. Kolgjoka (Hoxha) me numër personal {***} dhe numër karte identiteti {***}, z. D.S.K. me numër personal {***} dhe numër karte identiteti {***}, znj. F.Z.H. me numër personal {***}, z. E.S.H. i datëlindjes 19.01.1984.

Në përgjigje të kërkesës së Kolegjit, DhKN, me shkresën nr. {***} prot., datë 15.06.2020, e protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 16.06.2020, informon se në lidhje me aktet noteriale të kryera nga noterët në Republikën e Shqipërisë, Kolegji duhet t’i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë, pasi është institucioni që disponon regjistrin e përgjithshëm elektronik të akteve noteriale, ndërsa përpara vitit 2013 nuk ka pasur një regjistër të tillë.

21. Pas depozitimit në Kolegj, informacionet dhe aktet e përcjella nga këto subjekte në përgjigje të kërkesave të Kolegjit, i janë përcjellë zyrtarisht Komisionerit Publik, subjektit të rivlerësimit dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, të cilët në seancën e datës 19.06.2020 konfirmuan se e kanë marrë këtë dokumentacion.

22. Në seancën e datës 19.06.2020, subjekti i rivlerësimit, me qëllimin për të provuar mungesën e konfliktit të interesit ndërmjet saj si subjekt rivlerësimi dhe babait të saj, si dhe dy shoqërive private që i kanë shitur atij apartamentin objekt gjykimi, i kërkoi Kolegjit marrjen dhe shqyrtimin në seancë gjyqësore të këtyre provave:

22.1 Vërtetim nr. {***} prot., datë 10.03.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, sipas të cilit znj. Alma Hoxha ka ushtruar detyrën e gjyqtare në këtë gjykatë nga 5 tetor 2007 deri në 25 mars 2009.

22.2 Vërtetim nr. {***} prot., datë 06.03.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, sipas të cilit, nga verifikimet e kryera në arkivin e kësaj gjykate, nuk rezulton të jetë zhvilluar asnjë gjykim me palë ndërgjyqëse shtetasin S.H., me gjyqtare Alma Hoxha, në periudhën që kjo e fundit ka qenë gjyqtare pranë kësaj gjykate.

22.3 Vërtetim nr. {***} prot., datë 06.03.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, sipas të cilit, nga verifikimet e kryera në arkivin e kësaj gjykate, nuk rezulton të jetë zhvilluar asnjë gjykim me palë ndërgjyqëse shoqërinë “{***}” ShPK, me gjyqtare Alma Hoxha, në periudhën që kjo e fundit ka qenë gjyqtare pranë kësaj gjykate.

22.4 Vërtetim nr. {***} prot., datë 06.03.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, sipas të cilit, nga verifikimet e kryera në arkivin e kësaj gjykate, nuk rezulton të jetë zhvilluar asnjë gjykim me palë ndërgjyqëse shoqërinë “{***}” ShPK, me gjyqtare Alma Hoxha, në periudhën që kjo e fundit ka qenë gjyqtare pranë kësaj gjykate.

22.5 Vërtetim nr. {***} prot., datë 09.03.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, sipas të cilit znj. Alma Kolgjoka (Hoxha) ushtron detyrën e gjyqtares në këtë gjykatë, nga data 25 mars 2009 e në vijim.

22.6 Vërtetim nr. {***} prot., datë 09.03.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, sipas të cilit, nga verifikimet e kryera në arkivin e kësaj gjykate, nuk rezulton të jetë zhvilluar asnjë gjykim me gjyqtare Alma Kolgjoka (Hoxha), me palë ndërgjyqëse: shoqërinë “{***}” SHPK, shoqërinë “{***}” SHPK, si dhe me shtetasin S.H..

22.7 Kërkesë, pa datë, e znj. Alma Kolgjoka (Hoxha) drejtuar znj. V.S., notere pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, nëpërmjet së cilës kërkohet nëse për pasurinë apartament banimi të blerë nga z. S.H., me “Kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme me rezervë”, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.07.2012, ekzistojnë kontrata të mëparshme, të lidhura mes shoqërisë “{***}” ShPK dhe z. S.H., apo me shtetasit e tjerë: Alma S.Hoxha., Alma S. Kolgjoka, F. H., E. H. dhe D. K..

22.8 Shkresë “Kthim përgjigjeje” pa nr. prot., datë 15.06.2020, e noteres V. S., drejtuar znj. Alma Kolgjoka (Hoxha), në të cilën informon kërkuesen se, në cilësinë e noteres, znj. S. ka realizuar kontratat paraprake të shitblerjes me rezervë dhe ato përfundimtare për objektin e shoqërisë “{***}” ShPK në rrugën “{***}” dhe se për z. S.H. nuk janë nënshkruar kontrata të tjera të mëparshme pranë zyrës së saj noteriale, apo dhe me persona të tjerë që lidhen me z. S.H., me përjashtim të kontratës së shitblerjes me rezervë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.07.2012.

23. Këto akte të cilat u paraqitën edhe paraprakisht nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet postës elektronike³, u janë përcjellë zyrtarisht Komisionerit Publik dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, të cilët në seancën e datës 19.06.2020, konfirmuan se e kanë marrë këtë dokumentacion dhe se ishin të gatshëm për të zhvilluar debatin gjyqësor mbi këto akte.
24. Megjithëse aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit të renditura në paragrafët 22.1 - 22.6 të këtij vendimi, nuk u përgjigjeshin kërkesave të hetimit, pasi ky i fundit nuk ishte çelur për verifikimin e ekzistencës së konfliktit të interesit të gjyqtares gjatë ushtrimit të detyrës prej saj, ndërmjet saj dhe babait të saj, si dhe shoqërive përkatëse apo ortakëve të shoqërive, me të cilat z. S.H. ka lidhur “Kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme me rezervë”, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.07.2012, trupi gjykues vendosi të lejojë marrjen e tyre, së bashku me aktet e renditura në paragrafët 22.7 - 22.8 të këtij vendimi e më pas i vlerësoi ato në raport me vendimin objekti shqyrtimi dhe shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik.
25. Pas marrjes së provave si rezultat i hetimit të kryer nga trupi gjykues i Kolegjit dhe atyre të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, Komisioneri Publik dhe subjekti i rivlerësimit çmuan se hetimi gjyqësor ishte i plotë dhe nuk ishte e nevojshme marrja e provave të reja.

C. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit në lidhje me pretendimet sipas shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

26. Lidhur me shkakun e ankimit se Komisioni ka bërë vlerësim të gabuar të situatës faktike bazuar në aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, pasi rrethanat ligjore që paraqiten për pasurinë apartament me sipërfaqe 141,87 m² në Tiranë, janë të tilla që e lidhin subjektin e rivlerësimit në marrëdhënie interesi që rrjedh nga një interes pasuror me babain

³ Nëpërmjet e-mail-it, datë 11.06.2020, të protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 11.06.2020, si dhe e-mail-it, datë 15.06.2020, të protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 15.06.2020.

e saj, z. S.H., e për këtë arsye babai i saj duhet të cilësohej si “person tjetër i lidhur”, trupi gjykues konstaton sa më poshtë.

27. Komisioni, në kontrollin dhe vlerësimin e kësaj pasurie gjatë procesit të rivlerësimit, është shprehur në vendim⁴: *Gjatë hetimit administrativ, Komisioni konstatoi disa adresa të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike, në pyetësonin standard, si dhe gjatë verifikimit pranë sistemit të OShEE-së. Lidhur me këto adresa, Komisioni hetoi mbi faktin nëse subjekti i rivlerësimit nuk kishte deklaruar ndonjë pasuri në pronësi, posedim, përdorim, apo me qira për pasuritë lidhur me adresat e mëposhtme: [...]. Për këto adresa dhe për të dhëna që rezultuan nga hetimi, Komisioni i kërkoi dhe mori deklaratime subjektit të rivlerësimit [...]. Trupi gjykues, lidhur me këto adresa vlerëson se dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, kopje të hartës së rrjetit rrugor të Njësisë Bashkiake Nr. {***}, "Formular ankesë/kërkese", nr. serie {***}, datë 02.11.2012, drejtuar OShEE-së, kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme me rezervë, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.07.2012, kanë qartësuar lidhjen e subjektit me këto adresa, për të cilat Komisioni, duke vlerësuar faktet e dala nga hetimi i thelluar, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe ligjin e zbatueshëm, çmon se nuk ka dyshime për pasuri të paluajtshme në pronësi, përdorim, apo me qira, në lidhje me adresat e deklaruara nga ana e subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, gjatë hetimit të thelluar, nga gjendja e akteve në dosje, trupi gjykues konstatoi se babai i subjektit, me anë të kontratës së shitblerjes me rezervë ligjore, ka blerë një apartament me sipërfaqe 141,87 m², në vitin 2012. Trupi gjykues edhe në këtë drejtim verifikoi rrethanat nëse subjekti mund të vishej, me ndonjë kualifikim të mundshëm si “person i lidhur”, apo “person tjetër i lidhur” në kuptim të nenit 3, pika 14 dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë drejtim, trupi gjykues konstatoi rrethanat se subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë në vitin 2011 dhe ka dalë me certifikatë më vete me familjen e saj të re, dhe në kuptim të ligjit nr. 84/2016, në periudhën që babai i saj ka blerë apartamentin (viti 2012), nuk e kualifikon atë si “person të lidhur” apo “person tjetër të lidhur”, në mënyrë që të bëhej vlerësimi i burimeve të ligjshme për këtë pasuri. Trupi gjykues arrin në këtë konkluzion edhe për sa kohë, nga hetimi administrativ, nuk i rezultoi ndonjë rrethanë tjetër ligjore që mund të lidhte subjektin e rivlerësimit me ndonjë kontribut/shpenzim të mundshëm të saj mbi këtë pasuri.*
28. Trupi gjykues i Kolegjit, në lidhje me këtë konkluzion, nga verifikimi i akteve të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, konstaton rrethanat e faktit, si më poshtë.

28.1 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësonit standard të Komisionit të datës 01.03.2018, ka deklaruar: *Duke filluar nga muaji shkurt 2017 e në vijim, për shkak të futjes së vajzës në klasë të parë, për shkak të afërsisë së shkollës me shtëpinë e prindërve të mi, përkohësisht, në ditë të ndryshme, kam qëndruar te shtëpia e prindërve të mi, në adresën: Njësia Administrative Nr. {***}, rruga “{***}”, ndërtesa {***}, hyrja {***}, apartamenti {***}, Tiranë.*

Nisur nga ky deklaram i subjektit, Komisioni, në pyetësonin vijues të datës 19.10.2018, i ka kërkuar shpjegime në lidhje me pronësinë e kësaj pasurie.

Në përgjigjen e dërguar në Komision, nëpërmjet e-mail-it të datës 22.10.2018, subjekti shpjegon: *Në lidhje me pyetjen e parë, pasuria e deklaruar nga ana ime në pyetësonin standard të Komisionit, datë 01.03.2018, është në pronësi të babait tim, shtetasit S. A. H.. Për të provuar këtë fakt, paraqes “Kontratë shitblerjejeje pasurie e paluajtshme me rezervë” nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.07.2012. Në lidhje me këtë apartament, ende nuk janë bërë ndryshimet pranë ZVRPP Tiranë për kalimin e pronësisë. Sqaroj se nga ana ime është deklaruar adresa e re që ky apartament disponon aktualisht, pas përditësimit të sistemit të adresave, për të cilin kemi ardhur në dijeni nga njoftimi që është ngjitur në derën e*

⁴ Shih faqet 9-11 të vendimit nr. 86, datë 17.12.2018, të Komisionit.

apartamentit. Për të vërtetuar këtë fakt, paraqes para jush kopje të njoftimit të adresës së re të ndodhur në derën e apartamentit. Gjithashtu, për të vërtetuar këtë pretendim, paraqes kopje të hartës së rrjetit rrugor të Njësisë Bashkiake Nr. {***}, ku është pasqyruar ku ndodhet pallati në fjalë (ku ndodhet edhe apartamenti në pronësi të babait tim) dhe rruga përkatëse, si dhe harta e emërimit të rrugëve të Bashkisë Tiranë.

Në lidhje me pyetjen e dytë, ju sqaroj se kontrata e furnizimit me OShEE nr. {***} në emër të babait tim, shtetasit S.H., i përket pikërisht apartamentit që është deklaruar nga ana ime se përkohësisht në ditë të ndryshme kam qëndruar për shkak të afërsisë së shkollës së vajzës (pasi shtëpia ime ndodhet shumë larg, tek ish-***). Pra, bëhet fjalë për të njëjtin apartament, për të cilin babai im ka nënshkruar kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme me rezervë, datë 30.07.2012, dhe apartamentin e deklaruar nga ana ime në pyetësorin standard të Komisionit, datë 01.03.2018. Por, si kontrata e shitblerjes, dhe kontrata e furnizimit me OShEE kanë pasqyruar adresën e vjetër që ka pasur ky apartament (rruga “{***}”). Kurse nga ana ime është deklaruar si adresë, adresa e re e këtij apartamenti për të cilin jemi vënë në dijeni nga njoftimi i ngjitur te dera e apartamentit.

Gjithashtu, dua të sqaroj se pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme me rezervë, datë 30.07.2012, nga babai im, shtetasi S.H., më datë 02.11.2012, është kërkuar pranë OShEE ndryshimi i emrit nga {***} (firma ndërtuese) te blerësi S.H.. Për të provuar këtë fakt paraqes “Formulari ankesë/kërkesë” nr. serie {***}, datë 02.11.2012, drejtuar OShEE. Më pas ndryshimi i emrit është bërë edhe te kontrata për shërbim ujësjellës kanalizime nr. {***}.

28.2 Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti për të provuar deklaratimet e mësipërme, rezulton se babai i subjektit të rivlerësimit, z. S.H., në cilësinë e palës blerëse, ka lidhur në Tiranë, para noterës V.S., kontratën e shitblerjes së pasurisë të paluajtshme me rezervë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.07.2012, me palën shitëse shoqërinë “{***}” ShPK⁵, me objekt premtim shitje apartamenti, me sipërfaqe totale ndërtimi 141,87 m². Çmimi i blerjes së pasurisë objekt kontrate është 11065860 lekë⁶. Blerësi S.H. ka shlyer të gjithë detyrimin që rrjedh nga kjo kontratë në çastin e nënshkrimit të saj, përveç shumës prej 5.000 eurosh, që do ta likuidojë në çastin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitjes⁷.

28.3 Sipas “Formularit ankesë/kërkesë”, me nr. serie {***}, datë 02.11.2012, drejtuar OshEE ShA, rezulton se z. S.H., më datë 02.11.2012, ka bërë kërkesë për ndryshim emri, nga “{***}” (firma ndërtuese e apartamentit), në S.H..

Kontrata për shërbim ujësjellës-kanalizime nr. {***}, për konsumatorin familjar, z. S.H., mban datën 07.12.2012. Të dhënat e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit janë konfirmuar edhe nga UKT ShA, nëpërmjet informacionit të përcjellë në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 14.02.2018, dhe nga OShEE ShA, nëpërmjet informacionit të përcjellë në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 20.02.2018.

28.4 Nga informacioni i përcjellë në Komision nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë (në vijim “ZVRPP”), me shkresën nr. {***} prot., datë 22.02.2018, z. S.H. ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme vetëm një pasuri aktive, e llojit apartament, me sipërfaqe 78,9 m², me adresë: rruga “{***}”, pall. {***}, Tiranë, me nr. pasurie {***}, vol. {***} faqe {***}, {***}. Ky informacion përputhet me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ në Komision, se për pasurinë apartament

⁵ Sipas paragrafit “Kushte paraprake të përgjithshme” të kontratës së shitjes me rezervë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.07.2012, shoqëria “{***}” ShPK e ndërton objektin nëpërmjet shoqërisë ndërtuese “{***}” ShPK, sipas kushteve të kontratës së sipërmarrjes të lidhur ndërmjet tyre me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.04.2010.

⁶ Sipas nenit 3 të kontratës së shitjes me rezervë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.07.2012.

⁷ Sipas nenit 4 të kontratës së shitjes me rezervë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.07.2012.

me sipërfaqe 141,87 m², në pronësi të babait të saj sipas “Kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme me rezervë” nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.07.2012, ende nuk janë bërë ndryshimet pranë ZVRPP Tiranë për kalimin e pronësisë.

28.5 Gjatë hetimit administrativ, rezulton se Komisioni u është drejtuar institucioneve bankare publike dhe private, duke kërkuar informacion⁸ në lidhje me çdo veprimtari/transaksion bankar dhe financiar për personat: Alma Kolgjoka, D.K., A.K., D.K., S.H., F.H., S.K. dhe M. K.. Nga informacionet e përcjella në Komision nga këto institucione, rezulton se babai dhe nëna e subjektit të rivlerësimit kanë pasur llogari bankare në bankat Intesa San Paolo dhe Raiffeisen⁹. Nga verifikimi i llogarive bankare të z. S.H. dhe znj. F.H. në Bankën Intesa San Paolo, për periudhën 2002-2012, rezulton se ata nuk kanë kryer transaksione bankare me vajzën e tyre Alma Kolgjoka (Hoxha). Nga verifikimi i llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit në Bankën Raiffeisen, për periudhën 2002-2012, rezulton se ajo nuk ka kryer transaksione bankare me z. S.H., znj. F.H dhe as me vëllain e saj, z. E.H., për rrjedhojë nuk rezultuan të dhëna që të rrëzojnë prapësimet e subjektit të rivlerësimit në kundërankim, se ajo nuk ka kryer dhënie apo marrje parash nëpërmjet transaksioneve bankare me anëtarët e familjes së saj së origjinës, për periudhën 2005-2012.

28.6 Nga verifikimi i deklaratave të pasurisë së subjektit të rivlerësimit në vite, të përcjella në Komision nga ILDKPKI-ja, trupi gjykues konstaton se në këto deklarata, në rubrikën për përbërjen familjare, subjekti në vitin 2007 ka deklaruar vetëm veten e saj, në cilësinë e deklaruesit, me adresën e plotë ku ka qenë e regjistruar në gjendjen civile: Lagjja nr. {***}, rruga “{***}”, pallati {***}, shkalla {***}, ap. {***}, Tiranë; në vitet 2008 dhe 2009 ka deklaruar përbërjen familjare sipas certifikatës së gjendjes civile, me babain, nënën dhe vëllain në adresën e plotë ku ka qenë e regjistruar në gjendjen civile: Lagjja nr. {***}, rruga “{***}”, pallati {***}, shkalla {***}, ap. {***}, Tiranë; në vitin 2010 ka deklaruar përbërjen familjare me bashkëshortin dhe vajzën e lindur më datë 21.01.2011; në vitin 2011 e në vijim, deri në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar përbërjen familjare sipas certifikatës së gjendjes civile me bashkëshortin dhe vajzën e më pas me djalin, në adresën e plotë ku ka qenë e regjistruar në gjendjen civile: Njësia Bashkiake Nr. {***}, rruga “{***}”, shtëpi private nr. {***}, Tiranë. Sipas certifikatës së martesës, e paraqitur nga subjekti bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, rezulton se subjekti ka lidhur martesë më datë 31.01.2011.

28.7 Komisioni me shkresën nr. {***} prot., datë 02.02.2018, i është drejtuar zyrës së regjistrimit noterial në Ministrinë e Drejtësisë, duke kërkuar të dhëna mbi pasuritë e paluajtshme të përfituara nga ndonjë akt noterial i regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për personat: Alma Kolgjoka, D.K., A.K., D.K., S.H., F. H., S. K. dhe M.K.. Në përgjigjen e përcjellë në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 14.02.2018, Ministria e Drejtësisë ka bashkëlidhur listën e veprimeve noteriale duke filluar nga data 01.03.2013 deri më datë 13.02.2018, të kryera nga shtetasit Alma Kolgjoka, D.K. dhe S. K..

28.8 Nga verifikimi i deklaratave të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, të dorëzuara në ILDKPKI në vitet 2007¹⁰ - 2010¹¹, konstatohet se subjekti ka deklaruar vetëm të ardhura nga paga e saj si gjyqtare dhe nuk ka deklaruar kursime në asnjë lloj forme, as kursime *cash* dhe as të depozituara në sistemin bankar. Edhe në deklarimin e pasurisë për vitin 2011 dhe

⁸ Komisioni u është drejtuar institucioneve bankare publike dhe private me shkresën nr. {***} prot., datë 05.02.2018.

⁹ Banka Intesa San Paolo i ka kthyer përgjigje Komisionit me shkresën nr. {***} prot., datë 08.02.2018, ndërsa Banka Raiffeissen me shkresën nr {***} prot., datë 07.02.2018.

¹⁰ Viti 2007 është viti i fillimit të deklarimit të pasurisë nga subjekti i rivlerësimit.

¹¹ Më datë 31.01.2011, subjekti ka lidhur martesë dhe është shkëputur nga familja e origjinës, duke dalë me certifikatë familjare më vete me familjen e saj të re.

2012¹², kur subjekti kishte krijuar familjen e saj dhe ishte ndarë nga familja e origjinës, ka deklaruar vetëm të ardhurat nga paga e saj dhe nga paga e bashkëshortit, dhe nuk ka deklaruar kursime, dhënie huaje apo dhurime te persona të tjerë.

29. Komisioneri Publik në ankim dhe në parashtrimet në seancën gjyqësore të datës 19.02.2020, kundërshtoi këtë arsyetim të Komisionit në vendim, me pretendimin se Komisioni ka bërë vlerësim të gabuar të situatës faktike, bazuar në aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, pasi rrethanat ligjore që paraqiten për pasurinë apartament me sipërfaqe 141,87 m², janë të tilla që e lidhin subjektin e rivlerësimit në marrëdhënie interesi që rrjedh nga një interes pasuror me babain e saj, z. S.H., së paku sipas dy rrethanave faktike:
- a) Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar përbërje familjare për vitet 2008, 2009, 2010 të njëjtë me z. S.H. dhe, nën regjimin e ekonomisë familjare të prezumuar, derisa nuk është provuar e kundërta, ka kontribuar në krijimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 141,87 m².
- b) Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, ka deklaruar qëndrimin me ditë në shtëpinë e prindërve, rrjedhimisht është në kushtet e përdorimit të sendit të paluajtshëm, apartament me sipërfaqe 141,87 m².
- Nën dritën e sa më sipër, i ati i subjektit të rivlerësimit, ka pretenduar Komisioneri Publik, duhej të cilësohej si person tjetër i lidhur.
30. Lidhur me këtë shkak të ankimit, subjekti i rivlerësimit parashtrroi në kundërankim dhe në seancën gjyqësore të datës 19.02.2020 se pretendimet e Komisionerit Publik lidhur me apartamentin e banimit janë të pabazuara në provat e administruara dhe të shqyrtuara nga Komisioni, si dhe në ato të dorëzuara prej saj në Komision, duke prapësuar sa vijon.
- Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur asnjë marrëdhënie interesi që rrjedh nga një interes pasuror me babain e saj, z. S.H., pasi gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, nga institucionet bankare është konfirmuar fakti se ndërmjet subjektit, babait, nënës dhe vëllait të saj nuk është kryer ndonjë transaksion financiar, pavarësisht nga vlera apo qëllimi i tij. Sipas përgjigjeve zyrtare të ardhura në Komision gjatë zhvillimit të procesit të rivlerësimit, nga zyrat e noterisë në të gjithë Shqipërinë, nuk rezultoi asnjë rast që ndërmjet subjektit dhe familjarëve të saj të jetë kryer ndonjë veprim juridik në formën e një kontrate huaje, dhurimi, ose çdo lloj tjetër veprimi juridik. Subjekti ka prapësuar gjithashtu, se paga e marrë nga ana e saj si stazhiere pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për periudhën 2007-2009, dhe më pas si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë ka qenë e gjitha e nevojshme për të mbuluar shpenzimet e saj personale, ku si shpenzime shtesë kanë qenë edhe shpenzimet e transportit, të cilat nuk janë mbuluar asnjëherë nga shteti. Në deklaratat e pasurisë në vitet 2007-2012, subjekti nuk ka deklaruar asnjëherë kursime dhe më pas pakësime nga viti në vit, duke provuar kështu se nuk ka pasur asnjë mundësi objektive për të kontribuar në krijimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 141,87 m² në pronësi të babait të saj. Subjekti ka argumentuar se martesë e një personi nuk nënkupton shpëputjen me familjen e origjinës. Një fëmijë nuk ka ligjrisht dhe moralisht asnjë pengesë ose limit në kohë, se sa herë shkon në familjen e prindërve të tij, për më tepër që kjo marrëdhënie njerëzore të trajtohet si marrëdhënie interesi. Arsyet e shkuarjes së saj të shpeshtë në apartamentin e familjes së origjinës, përgjatë vitit shkollor 2017 kanë qenë kushtëzuar nga largësia e banesës së saj të ndodhur në periferi të Tiranës, me shkollën e vajzës së saj. Gjithashtu, prindërit e kanë ndihmuar në rritjen dhe përkujdesjen për fëmijët e saj të mitur, për sa kohë ajo ka punuar e punon jashtë Tiranës dhe, së bashku me bashkëshortin, kanë qenë në pamundësi objektive të kujdeseshin të vetëm për ta.
31. Në qëndrimin e tij në seancën e datës 19.06.2020, Komisioneri Publik vlerësoi se aktet e depozituara në Kolegj, si rezultat i hetimit të zhvilluar prej këtij të fundit, ashtu siç janë

¹² Viti kur babai i subjektit të rivlerësimit ka lidhur kontratën e shitblerjes me rezervë të pasurisë apartament me sipërfaqe 141, 87 m².

pasqyruar në paragrafin 21 të këtij vendimi, kanë dhënë informacion të mjaftueshëm në drejtim të shërimit të hetimit të çelur, në lidhje me marrëdhënien e z. S.H., babai i subjektit të rivlerësimit, me pasurinë apartament me sipërfaqe 141,87 m² në Tiranë. Sipas Komisionerit Publik, informacioni i përcjellë nga shoqëritë “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK tregon se nuk ka kontrata të tjera të mëparshme të lidhura nga këto shoqëri me z. S.H. apo edhe me persona të tjerë, përveç kontratës së shitblerjes të pasurisë së paluajtshme me rezervë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.07.2012. Komisioneri Publik vlerësoi se informacioni i përcjellë në Kolegj nga shoqëria UKT ShA jep të dhëna për pagesat e kryera nga z. S.H. për furnizimin me ujë të apartamentit me sipërfaqe 141,87 m², duke rezultuar se deri në muajin gusht 2012, në këtë apartament nuk ka pasur konsum dhe përdorim të rrjetit të ujësjellës-kanalizimeve. Të njëjtin vlerësim Komisioneri Publik e bëri edhe për informacionin e përcjellë në Kolegj nga shoqëria FShU ShA-OSHEE GROUP ShA, duke rezultuar, sipas tij, se deri në muajin gusht 2012, në apartamentin në fjalë nuk ka pasur konsum të energjisë elektrike. Në lidhje me informacionin e përcjellë në Kolegj nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe vërtetimin e noterës publike V.S. të paraqitur në Kolegj nga subjekti i rivlerësimit, Komisioneri Publik vlerësoi se vërtetohet që për babain e subjektit, z. S.H., nuk janë nënshkruar kontrata të tjera të mëparshme pranë zyrës së noterës, apo dhe me persona të tjerë të lidhur me z. S.H..

32. Në debatin gjyqësor në lidhje me aktet e përcjella në Kolegj si rezultat i hetimit administrativ të kryer prej tij¹³, subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin se nga përmbajtja e këtyre akteve provohet në mënyrë shteruese se z. S.H., babai i saj, nuk mund të përkufizohet si person tjetër i lidhur me të, pasi ai nuk ka qenë në asnjë rast në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit apo huamarrësit kundrejt saj. Gjithashtu, sipas subjektit, rezultoi e provuar se ndërmjet saj dhe babait të saj, apo çdo pjesëtari tjetër të familjes së saj të origjinës, nuk ekziston asnjë interes pasuror apo çdo marrëdhënie biznesi në kuptim të ligjit nr. 84/2016, si në formën e një transaksioni financiar, kontrate dhurimi, huadhënie, huamarrjeje apo çdo veprimi tjetër juridik të çfarëdoshëm.
33. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga palët lidhur këtë shkak të ankimit si më sipër në këtë vendim, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi situatën faktike të rezultuar nga hetimi administrativ i Komisionit dhe nga hetimi e shqyrtimi gjyqësor në Kolegj, duke e analizuar atë në kuptim të përcaktimit të parashikuar nga neni 3, pika 14 dhe neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Në kuptim të këtyre dispozitave dhe të qëndrimeve tashmë të mbajtura në jurisprudencën e Kolegjit, trupi gjykues çmon se vlerësimi i rrethanave të faktit në rastin konkret duhet të fokusohet në analizën nëse z. S.H., babai i subjektit të rivlerësimit, gjendet ose jo në kushtet që e kualifikojnë atë me cilësimin “person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit”.

Sipas përkufizimit të dhënë në pikën 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016¹⁴, që një person fizik ose juridik të konsiderohet si “person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit”, duhet që të provohet një lidhje interesi mes tyre, e cila duhet të rrjedhë nga:

- i) një interes pasuror; ose
- ii) çdo marrëdhënie tjetër biznesi.

Përkufizimi i marrëdhënies së biznesit gjendet në radhën e përkufizimeve të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, në pikën 9 të tij¹⁵. Ndërsa lidhja e interesit që rrjedh nga një interes pasuror është

¹³ Në seancën e datës 19.06.2020.

¹⁴ Neni 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016¹⁴, parashikon: “Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik, që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi.

¹⁵ Neni 3, pika 9 e ligjit nr. 84/2016 përcakton: 9. “Marrëdhënie biznesi” është çdo marrëdhënie profesionale ose tregtare, e cila lidhet me veprimtaritë e ushtruara nga subjektet e këtij ligji dhe klientët e tyre, që, në çastin

trajtuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ku përcaktohet në mënyrë specifike se cilat marrëdhënie do të përfshihen në sferën e interesit pasuror. Sipas kësaj dispozite: *Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.* Pra, interesi pasuror duhet të jetë një marrëdhënie dhurimi, huamarrjeje ose huadhënieje ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe një personi fizik ose juridik. Në zbatim të këtij kuadri ligjor, subjekti i rivlerësimit, për efekt të procesit të rivlerësimit, detyrohet të provojë burimin e ligjshëm të pasurisë së personit tjetër të lidhur, për pasurinë e përfshirë në marrëdhënien e konfirmuar të dhurimit apo huas.

34. Subjekti i kontrollit në procesin e rivlerësimit është subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, prandaj specifika e procesit të rivlerësimit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-32 të ligjit nr. 84/2016 është që detyrimin për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë dhe të të ardhurave e ka vetë subjekti i rivlerësimit, përfshirë këtu edhe detyrimin për të provuar burimin e ligjshëm të pasurisë së krijuar nga dhurime apo huamarrje të konfirmuara nga persona të tjerë të lidhur, si dhe të pasurisë së dhënë hua apo të dhuruar nga vetë subjekti i rivlerësimit. Në interpretim të këtyre dispozitave kushtetuese dhe ligjore, provueshmëria e ligjshmërisë së burimeve të pasurisë së dhuruar apo të dhënë hua nga apo te personat e tjerë të lidhur, është një proces në të cilin vetë subjekti i rivlerësimit duhet të provojë ligjshmërinë e burimit, ndërkohë që edhe vetë personat e tjerë të lidhur kanë detyrimin të provojnë ligjshmërinë e burimeve për krijimin e pasurisë së dhuruar ose huazuar, nëse konfirmojnë marrëdhënien sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
35. Duke u kthyer në zbatimin e këtyre dispozitave në rastin konkret, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se bie prezumimi i Komisionerit Publik në ankim, se subjekti i rivlerësimit nën regjimin e ekonomisë së përbashkët familjare ka kontribuar në krijimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 141,87 m² në pronësi të babait të saj, pasi nga aktet e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni dhe nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit gjatë gjykimit në Kolegj, rezultoi e provuar se nuk janë kryer transaksione bankare ndërmjet saj dhe babait, nënës ose vëllait të saj deri në datën 30.07.2012¹⁶, datë e lidhjes së kontratës së shitblerjes të pasurisë së paluajtshme me rezervë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.07.2012, dhe e shlyerjes së detyrimit kontraktor në vlerën 10.378.560 lekë për blerjen e pasurisë apartament, me sipërfaqe 141,87 m². Gjithashtu, nga verifikimi i deklaratave të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, të dorëzuara në ILDKPKI në vitet 2007¹⁷ - 2010¹⁸, konstatohet se subjekti ka deklaruar vetëm të ardhura nga paga e saj si gjyqtare dhe nuk ka deklaruar kursime në asnjë lloj forme, as kursime *cash* dhe as të depozituara në sistemin bankar. Edhe në deklarin e pasurisë për vitet 2011 dhe 2012¹⁹, kur subjekti kishte krijuar familjen e saj dhe ishte ndarë nga familja e origjinës, ka deklaruar vetëm të ardhurat nga paga e saj dhe e bashkëshortit dhe nuk ka deklaruar kursime, dhënie huaje apo dhurime te persona të tjerë.
36. Nga analizimi i situatës faktike të rezultuar nga hetimi i kryer në Kolegj në drejtim të verifikimit të marrëdhënies së babait të subjektit të rivlerësimit me pasurinë apartament 141,87 m², trupi gjykues vlerëson se nga aktet e përcjella në Kolegj nga shoqëria “{***}” ShPK, “{***}” ShPK dhe nga noterja publike V.S., rezultoi e provuar se marrëdhënia e

e vendosjes së saj, vlerësohet të jetë një marrëdhënie e vazhdueshme ose jo, sipas ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.

¹⁶ Për periudhën 2005-2012.

¹⁷ Viti 2007 është viti i fillimit të deklarinimit të pasurisë nga subjekti i rivlerësimit.

¹⁸ Më datë 31.01.2011, subjekti ka lidhur martesë dhe është shkëputur nga familja e origjinës, duke u regjistruar në një trung familjar më vete, me familjen e saj të re.

¹⁹ Viti kur babai i subjektit të rivlerësimit ka lidhur kontratën e shitblerjes me rezervë të pasurisë, apartament me sipërfaqe 141, 87 m².

babait të subjektit të rivlerësimit me pasurinë apartament me sipërfaqe 141,87 m² është e kufizuar vetëm në lidhjen e kontratës së shitblerjes të pasurisë së paluajtshme me rezervë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.07.2012 dhe shlyerjen në të njëjtën datë të detyrimit kontraktor në vlerën 10.378.560 lekë për blerjen e kësaj pasurie. Në këtë kuptim, marrëdhënia kontraktore dhe shlyerja e detyrimit kontraktor nga babai i subjektit të rivlerësimit për pasurinë apartament me sipërfaqe 141,87 m² kanë ndodhur pas datës 31.01.2011, datë në të cilën subjekti i rivlerësimit është shkëputur nga trangu familjar i origjinës për shkak të martesës. Rezultoi e provuar, gjithashtu, se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të [bashkëshorti] nuk kanë hyrë në marrëdhënie kontraktore për këtë pasuri, me palë të treta apo edhe me z. S.H.

Nga informacioni i përcjellë në Kolegj nga shoqëria FShU ShA dhe UKT ShA në lidhje me kontratat përkatëse të furnizimit me energji dhe ujë në emër të z. S.H., babait të subjektit të rivlerësimit, dhe pagesat e kryera për konsumin e ujit dhe të energjisë elektrike, trupi gjykues vlerëson se rezultoi e provuar se familja e origjinës së subjektit të rivlerësimit ka filluar të përdorë për banim apartamentin me sipërfaqe 141,87 m², pasi subjekti i rivlerësimit është shkëputur nga trangu familjar i origjinës për shkak të martesës.

37. Trupi gjykues, nga verifikimi i akteve të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni dhe nga shqyrtimi i akteve të hetimit gjyqësor të kryer në Kolegj, vëren se nuk rezulton që ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe babait të saj të jetë deklaruar e konfirmuar ndonjë veprim juridik, i tillë që të përmbushë kërkesat e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, konkretisht dhurim, huamarrje ose huadhënie.
38. Në rrethanat faktike konkrete, trupi gjykues vlerëson se nuk u provua përfshirja e drejtpërdrejtë apo e tërthortë e subjektit të rivlerësimit në krijimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 141,87 m², me qëllim vlerësimin e besueshmërisë së saj në raport me procesin e rivlerësimit. Trupi gjykues çmon se provat e administruara në gjykim provuan mjaftueshëm mungesën e marrëdhënies së interesit të subjektit të rivlerësimit me babain e saj, në kuptim të pikës 14 të nenit 3 dhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.
39. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioneri Publik, pretendimin e tij në ankim se babai i subjektit të rivlerësimit duhej të cilësohej nga Komisioni si person tjetër i lidhur, e ka lidhur edhe me rrethanën faktike të pranuar edhe nga vetë subjekti gjatë hetimit administrativ të Komisionit, se ajo ka qëndruar me ditë në shtëpinë e prindërve për shkak të nevojave të saj për rritjen e fëmijëve dhe, për këtë fakt, ajo është në kushtet e përdorimit të sendit të paluajtshëm, apartament me sipërfaqe 141,87 m². Nga verifikimi i akteve të hetimit administrativ të kryer në Komision, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjatë hetimit se në shtëpinë e prindërve ka qëndruar përkohësisht në ditë të ndryshme për shkak të afërsisë së shkollës së fëmijës së saj me shtëpinë e prindërve. Gjithashtu, ka deklaruar se prindërit e saj kujdesen edhe për fëmijën e saj të dytë.

Në kundërankim dhe gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, përtej asaj që kishte deklaruar gjatë hetimit administrativ në Komision²⁰, ka argumentuar se: *Qëllimi i qëndrimit përkohësisht në këtë apartament përgjatë vitit shkollor 2017-2018, për vizitë, për drekë, për darkë ose edhe për të fjetur ndonjëherë për shkak të orarit të zgjatur në punë dhe trafikut të rënduar në kthim, pasi kështu është kuptuar nga ana ime koncepti i "qëndrimit" në pyetjen e bërë nga Komisioni, nuk ka qenë për qëllime përdorimi për banim të këtij apartamenti. Nëse do të kisha këtë qëllim, e kisha përdorur si të tillë që në vitin 2012, kur është blerë, dhe jo pas pesë vjetësh.*

²⁰ Shih paragrafin 28.1 të këtij vendimi.

40. Në analizë të këtyre pretendimeve, trupi gjykues i Kolegjit çmon t’i drejtohet titullit V të Kodit Civil “Përdorimi e banimi”, i cili në nenin 259 parashikon: *Personi që ka një të drejtë thjesht përdorimi mbi një send, e përdor atë dhe gëzon frutet e tij në masën që ka nevojë për vete e për familjen e tij. Kur objekti i të drejtës së përdorimit është një banesë, personi ka të drejtë të banojë atje sipas nevojave të tij e të familjes së tij. Sendi ose banesa që përdoret sipas kësaj dispozite, nuk mund të tjetërsohet, të rëndohet dhe as të përdoret nga persona të tjerë.*

Sipas kësaj dispozite, sendi ose banesa nuk mund të përdoret nga persona të tjerë, por vetëm nga personi që ka të drejtën e përdorimit mbi të, në masën që ka nevojë për vete e për familjen e tij. Bazuar në të dhënat e certifikatave familjare të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, në të dhënat e plotësuara prej saj në lidhje me adresat e banimit sipas kërkesave të formularëve të deklaramit të pasurisë nga viti 2011, vit kur ajo është martuar dhe ka krijuar familjen e saj më vete, e në vijim, rezulton se subjekti nuk e ka përdorur pasurinë apartament me sipërfaqe 141,87 m² për qëllime banimi. Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratat e pasurisë asnjë të drejtë përdorimi mbi këtë apartament. Gjithashtu, nga deklaramet e subjektit dhe nga të dhënat e përcjella në Kolegj nga shoqëria FShU ShA dhe shoqëria UKT ShA në lidhje me pagesat e kryera për furnizimin me ujë dhe energji elektrike për këtë apartament, rezulton se prindërit e subjektit të rivlerësimit jetojnë në këtë apartament, duke e përdorur ata për qëllime banimi, që nga viti 2012. Mbështetur në këtë situatë faktike, trupi gjykues arrin në përfundimin se, në kundërshtim me sa ka pretenduar Komisioneri Publik në ankim, subjekti i rivlerësimit nuk është në kushtet e përdorimit të pasurisë së paluajtshme apartament me sipërfaqe 141,87 m², pasi nuk plotësohen kriteret e parashikuara nga neni 259, paragrafi i dytë i Kodit Civil.

41. Duke mbetur në kuadër të analizës për këtë shkak ankimi, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson të theksojë se qëndrimi i subjektit të rivlerësimit, përkohësisht, të të afërmit e sidomos të prindërit, në kushtet e marrëdhënieve familjare të përkujdesjes për prindërit apo e anasjella, si dhe të përkujdesjes së gjyshërve për nipërit, nuk mund të konsiderohet si përdorim i pasurisë së tyre nga fëmijët e tyre. Konsiderimi i pasurive të paluajtshme të prindërve të subjekteve të rivlerësimit si pasuri në përdorim të këtyre të fundit, thjesht vetëm për faktin se subjektet shkojnë të vizitojnë prindërit e tyre, qoftë edhe duke qëndruar disa ditë atje, është në tejkalim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit në procesin e rivlerësimit, i parashikuar nga neni 51, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.
42. Në përfundim të sa më sipër, lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik për cilësimin e z. S.H., babait të subjektit të rivlerësimit, si “person tjetër i lidhur” me subjektin e rivlerësimit, trupi gjykues arriti në konkluzionin se bazuar në parashikimin e pikës 14 të nenit 3, si dhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nuk u provua që ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe babait të saj të ketë pasur marrëdhënie interesi në lidhje me krijimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 141,87 m². Për rrjedhojë, z. S.H., babai i subjektit të rivlerësimit, nuk mund të konsiderohet si person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit.

Në këto kushte, ky shkak i ankimit të Komisionerit Publik gjendet nga trupi gjykues i Kolegjit i pabazuar në ligj dhe në prova.

43. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se me cilësimin si person tjetër të lidhur të babait të subjektit të rivlerësimit, Komisioni do të duhej të verifikonte edhe përmbushjen e detyrimit ligjor të justifikimit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 141,87 m², trupi gjykues konstaton se Komisioneri Publik në parashtrimet gjatë shqyrtimit gjyqësor, trajtimin e këtij shkak ankimi e lidhi ngushtësisht me vendimmarrjen e trupit gjykues në lidhje me cilësimin e z. S.H., babait të subjektit të rivlerësimit, si person tjetër të lidhur me të. Në përputhje dhe me vendimin e ndërmjetëm gjatë shqyrtimit gjyqësor

të çështjes, sipas të cilit cilësimi ose jo i babait të subjektit të rivlerësimit si person tjetër i lidhur me të, do të shprehej në vendimin përfundimtar, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i arritur në paragrafin 42 të këtij vendimi shërben si zgjidhje edhe për këtë shkak ankimi.

Z. S.H., babai i subjektit të rivlerësimit, nuk mund të konsiderohet si person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit, pasi, bazuar në parashikimin e pikës 14 të nenit 3, si dhe të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nuk u provua që ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe babait të saj të ketë pasur marrëdhënie interesi në lidhje me krijimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 141,87 m², pasi nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur cilësinë e dhuruesit, huadhënësit dhe huamarrësit kundrejt babait të saj, lidhur me këtë pasuri.

Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit nuk ka detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 141,87 m², në pronësi të babait të saj.

Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se edhe ky shkak ankimi i Komisionerit Publik rezultoi i pabazuar.

44. Në përfundim të shqyrtimit dhe vlerësimit të shkaqeve të ankimit të paraqitur nga Komisioneri Publik, në raport me arsyetimin dhe konkluzionet e Komisionit në vendimin nr. 86, datë 17.12.2018, aktet e administruara gjatë hetimit të kryer në Kolegj dhe shpjegimet e provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë se Komisioneri Publik, referuar nenit C, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, është pala që në gjykimin në Kolegj, me qëllim vlerësimin e procesit të rivlerësimit për subjektet e rivlerësimit, përfaqëson interesin publik, në funksion të garantimit dhe funksionimit të shtetit të së drejtës dhe pavarësisë në sistemin e drejtësisë, si edhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi. Në këtë kuptim, në ushtrim të kompetencave të tij gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor në Kolegj, Komisioneri Publik duhet të veprojë në përmbushje të këtij qëllimi, si dhe në respektim të plotë të parashikimeve të dispozitave procedurale në fuqi.

Në lidhje me çështjen objekt gjykimi, trupi gjykues vëren se pavarësisht mungesës së arsytimit të konkluzionit përfundimtar të Komisionerit Publik për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit e gjeti të drejtë këtë kërkim, në mbështetje të arsytimit të bërë më sipër në këtë vendim.

D. Mbi denoncimet e publikut të depozituara në Kolegj ndaj subjektit të rivlerësimit

45. Pranë Kolegjit, në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, janë depozituar denoncimet, si më poshtë:
- (i) Më datë 11.03.2019, u depozitua denoncimi i z. I. M.²¹.
 - (ii) Më datë 14.02.2020, u depozituan denoncimet e znj. M. S. dhe z. M. G.²², të përcjella nga Komisioneri Publik Dariel Sina.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së denoncimit të depozituar nga z. I. M., trupi gjykues konstatoi se lidhej me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, për të cilin Komisioneri Publik nuk kishte paraqitur ankim, si dhe vlerësoi se denoncimi nuk përmbante fakte apo rrethana, të cilat mund të përbënin provë në këtë proces gjyqësor, në përputhje me nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, për shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit për subjektin e rivlerësimit Alma Kolgjoka.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së denoncimeve të paraqitura nga znj. M. S. dhe z. M. G., trupi gjykues konstatoi se ato lidheshin me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit

²¹ Regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 11.03.2019.

²² Regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 14.02.2020.

të rivlerësimit. Ky kriter nuk ka qenë pjesë e ankimit të Komisionerit Publik, e rikonfirmuar prej këtij të fundit në seancën gjyqësore publike të datës 19.02.2019.

Në këtë seancë, Komisioneri Publik u shpreh që këto denoncime nuk përmbanin fakte apo rrethana, të cilat, në përputhje me nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, të mund të përbënin shkaqe për t'i ngritur në nivel ankimi.

Duke vlerësuar në tërësi se denoncimet nuk përmbanin fakte apo rrethana të cilat mund të përbënin provë në këtë proces gjyqësor, në përputhje me nenin 53, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, me vendim të ndërmjetëm, trupi gjykues u shpreh për mosçeljen e hetimit gjyqësor në lidhje me to.

46. Në përfundim të shqyrtimit të të gjitha shkaqeve të ankimit të ngritura nga Komisioneri Publik, për kriterin objekt ankimi, pas verifikimit të situatës faktike nëpërmjet çmuarjes së provave të administruara gjatë procesit të hetimit nga Komisioni, akteve të administruara nga hetimi gjyqësor i kryer nga Kolegji, dëgjimit të parashtrimeve të palëve në proces, në analizë të legjislacionit të zbatueshëm, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 141,87 m², i ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, në pronësi të babait të saj, pasi bazuar në parashikimin e pikës 14 të nenit 3, si dhe të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe babait të saj nuk u provua të ketë pasur marrëdhënie interesi në lidhje me krijimin e kësaj pasurie, në formën e dhurimit, huadhënies dhe huamarrjes kundrejt babait të saj, të tillë që të cilësonte këtë të fundit person tjetër të lidhur me subjektin e rivlerësimit.
47. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se vendimi nr. 86, datë 17.12.2018, i Komisionit, është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me shumicë votash, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 86, datë 17.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 25.06.2020.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi – kundër

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUES

Luan DACI

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, kam mbajtur qëndrim kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues për çështjen (JR) nr. 10/2019, datë 19.02.2019, me ankim të Komisionerit Publik (në vijim “Komisioneri”), kundër vendimit nr. 86, datë 17.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka.

Qëndrimin tim kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues, e mbështes në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, në ligjin nr. 84/2016, si dhe në provat dhe faktet e paraqitura në Komision dhe në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”).

2. ***Në rastin objekt gjykimi, ndryshe nga shumica e trupit gjykues, vlerësoj se mbështetur në ligj dhe në provat e administruara në Komision dhe në Kolegj, arrihet të provohet fakti se subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, ishte person i lidhur me babain e saj, z. S. H., në bazë të nenit 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”).***

Sipas përcaktimit ligjor në nenin 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016: “*Person i lidhur*” është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin dhe komisionerin publik, i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, **si dhe cdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin** e rivlerësimit, komisionerët, gjyqtarët dhe komisionerët publikë për periudhën e rivlerësimit.

3. Subjekti i rivlerësimit dhe babai i saj, z. S. H., çmoj se janë persona të lidhur për pasurinë apartament me sipërfaqe 141,87 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, me arsyetimin si me poshtë.

- Më datë 30.07.2012, nënshkruhet kontrata e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme me rezervë nr. rep. {***}, nr. {***} kol., mes shoqërisë {***} ShPK, në cilësinë e shitësit, dhe z. S. H., babait të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, në cilësinë e blerësit.

Referuar kontratës së shitblerjes së apartamentit me sipërfaqe 141,87 m², në vitin 2012, me vlerë 11.065.860 lekë, rruga “{***}”, Tiranë, në nenin 1, “Objekti i kontratës”, është përcaktuar qartë përkufizimi “njësi”, në të cilën përfshihet apartamenti i banimit dhe pjesët e përbashkëta.

Në nenin 5, pika 1 e kësaj kontrate, “Afati i përfundimit”, përcaktohet se koha e marrjes në dorëzim të njësisë së përmendur në nenin 1 të kësaj kontrate, ka qenë data 31.12.2010.

Pra, edhe pse kjo kontratë është nënshkruar në vitin 2012, sipas përcaktimit të nenit 5, pika 1 e saj, njësia objekt kontrate, apartamenti i dorëzohet blerësit më datë 31.12.2010.

- Në deklaratën e interesave privatë periodikë të vitit 2010, në përbërjen familjare (e cila duhet të jetë sipas certifikatës së gjendjes civile), rezulton të jetë deklaruar subjekti i rivlerësimit A.K., bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit D.K., si dhe vajza e subjektit të rivlerësimit A.K., ndërkohë që lidhja e martesës, sipas certifikatës përkatëse, rezulton më datë 30.01.2011 dhe lindja e vajzës më datë 21.01.2011. Në deklaratën e interesave privatë periodikë të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklarojë gjendjen e përbërjes familjare 01.01.2010 deri më datë 31.12.2010.

4. Në deklaratën e interesave privatë periodikë të vitit 2009, subjekti ka deklaruar si përbërje familjare, babain e saj, nënën dhe vëllain. Nisur nga fakti që martesë është lidhur në vitin

2011, subjekti i rivlerësimit duhet të deklaronte përbërjen familjare të ndryshuar në deklaratën e vitit 2011.

5. Sa më sipër, vlerësoj se deklarimi i përbërjes familjare të subjektit në deklarinimin e interesave privatë të vitit 2010, ku rezulton bashkëshorti dhe vajza e subjektit, përbën shkelje ligjore dhe me qëllim shmangien e babait të saj nga përbërja familjare, që do ta bënte person të lidhur, lidhur me pasurinë apartament me sipërfaqe 141,87 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë.
6. Bazuar në nenin D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës që parashikon: *Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarinimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të **identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur***”, gjykoj se subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, duhet ta kishte deklaruar këtë apartament.
7. Neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës parashikon: *Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon deklaratën e pasurisë në kohë sipas ligjit, ai shkarkohet nga detyra. Nëse subjekti i rivlerësimit **përpiqet të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij***, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

Në bazë të analizës më sipër, mendimi im është kundër, dhe trupi gjykues i Kolegjit, pas shqyrtimit të çështjes, duhet të ndryshonte vendimin nr. 86, datë 17.12.2018, të Komisionit dhe, në bazë të nenit 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, të vendoste shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Kolgjokaj.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi